



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 119/2013

Prishtinë, më 24.9.2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S–II

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Fikrim Damka, Sala Berisha–Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi dhe Myzejene Selmani dhe Etem Arifi.

Munguan: Teuta Sahatqija dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi–ZPRK, Burim Ejupi –INDEP, Besnik Ramadanaj –KDI, Naim Krasniqi –Radio Dukagjini dhe Jehona Sahiti, praktikante nga IND.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 17.9.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave;
4. Themelimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.9.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 17.9.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave;

Kryetari, tha se grupi i punës e ka shqyrtuar Projektligjin për sistemin e lejeve dhe licencave dhe ka hartuar disa amendamente. Kryesuese e grupit të punës është znj. Myzejene Selmani, të cilës më pas ia dha fjalën për t'i paraqitur amendamentet.

Myzejene Selmani, tha se grupi i punës ka mbajtur 4 takime si dhe një dëgjim publik, ku ishin pjesëmarrëses përfaqësuesit nga Zyra Ligjore e Kryeministrit, si sponsorues të këtij projektligji. Po ashtu aty ishin edhe organizata INDEP-it dhe palë të tjera. Gjatë mbledhjeve të grupit të punës kemi hartuar 27 amendamente.

Vërejtjet në projektligj dhe amendamente:

Shaip Muja, kërkoi sqarime shtesë lidhur me debatin që ka qenë në dëgjim publik, për disa paqartësi dhe kërkoi që limiti i caktuar për licencim nuk duhet të behët pengesë për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme, prandaj licencat nuk duhet të limitohen, por me këtë ligj duhet t'ju vihen kushte dhe kriteret se kur mund t'ju ndërpriten licencat, nëse nuk e zbatojnë Ligjin, sepse kështu janë të rregulluara licencat në shumë vende të BE-së, theksoi Muja.

Lutfi Zharku, tha se sa i përket qëndrimit tonë të Grupit Parlamentar të LDK-së, Projektligji për sistemin e lejeve dhe licencave, mbetemi pranë opinionit se ky projektligj është i pa nevojshëm, sepse këtë fushë e rregullon veç e veç çdo institucion në bazë të fushëveprimtarisë së vet. Mirëpo, në gjatë punës së grupit punues, nuk e kemi ndryshuar përmbajtjen e Projektligjit, por vetëm kemi rregulluar më shumë çështje teknike dhe administrative.

Myzejene Selmani, theksoi se nuk ka ndryshime të mëdha në amendamente, por kryesisht ato janë teknike, dhe më këto ndryshime është pajtuar edhe sponsoruesi.

Shaip Muja, kërkoi sqarime nga grupi punues, për nenin 26, të "pezullimi dhe revokimi i lejeve" sepse ky nen është shumë i shpërndarë në 13 paragrafë, edhe pse nuk është reduktuar dhe harmonizuar në amendamentin 25, duke u riformuluar.

Lutfi Zharku, tha se po që se do të kishim ndërhyrë në përmbajtje të Projektligjit, atëherë do të duhej të ndryshohej i tërë projektligji, prandaj janë bërë vetëm plotësime dhe ndryshime teknike.

Kryetari, tha se ideja për nxjerrjen e një projektligji të tillë, ka dal nga takimet e rregullta që dalin në Komisionin Ndërqeveritar për Zhvillim Ekonomik, ku marr pjesë edhe vet dhe është vlerësuar se duhet të këtë një ligj kornizë për të gjitha lejet dhe licencat në nivel vendi.

Komisioni, pas debatit nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohet Raporti me amendamente i grupit punues, për Projektligjin Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave;*
2. *Raporti t'u procedohet Komisioneve të përhershme sipas procedurës.*

4. Themelimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike;

Kryetari, tha që mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike është paraparë edhe në Planin e Punës, për vitin 2013, që është në fushëveprimin e Komisionit dhe e hapi debatin për formimin e grupit punues.

Sala Berisha – Shala, e përkrahu idenë e monitorimit të këtij ligji dhe kërkoi që të ftohen të gjithë deputetët në aktivitetet e Grupit të Punës, sipas interesimit.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

V E N D I M

1. *Formohet Grupi Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike;*
2. *Grupi punues ka këtë përbërje: Shaip Muja, raportues, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku, Myzejene Selmani dhe Etem Arifi;*
3. *Secili anëtarë i Komisionit, sipas interesimit mund të bashkëngjitet Grupit punues gjatë punës së tij;*
4. *Grupi Punues, në bashkëpunim me Njësinë Koordinuese të Komisionit, të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

5. Të ndryshme.

Çështjet vijuese

Myzejene Selmani, Propozoi që në mbledhjen e radhës në Komision, të ftohën për raportim përfaqësuesit e Autoriteti të Aviacionit Civil, lidhur me problemet e shumta që po paraqitën në “Aeroportin e Prishtinës Adem Jashari”, sidomos me bileta të udhëtarëve.

Hashim Deshishku, e përkrahu propozimin e deputetes Selmani dhe shtoi se është kompania e njëjtë, që sa herë me veprimet e saj po i dëmton udhëtarët.

Kryetari, kërkoi po ashtu, që të ftohet edhe ministri i infrastrukturës, lidhur me këtë që propozoi znj.Selmani, pasi që AAC- ja ka bashkëpunim të obligueshëm me Ministrinë e Infrastrukturës.

Komisioni u pajtua me propozimin e deputetes znj. Myzejene Selmani..

Shaip Muja, kërkoi sqarime për herë të tretë, lidhur më ftesën që i është bërë nga Komisioni për raportim znj. Mimoza Kusari-Lila, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, lidhur më vendimin e marr për masat e ndalimit tregtar të mallrave nga Republika e Maqedonisë, se pse nuk ka ardhur për të raportuar para Komisionit.

Kryetari, i njoftoi deputetët që e ka ftuar ministren për të raportuar, por ajo ka thënë se për shkak të agjendës së saj të ngjeshur, nuk mundet të vijë dhe të raportojë në Komision.

Shaip Muja, propozoi se pasiqë znj. Mimoza Kusari –Lila, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nuk po gjene kohë për raportim në Komision, atëherë të kërkohet nga ajo që më shkrim ta njoftojë Komisionin dhe ta dërgojë edhe një raport zyrtar, lidhur me vendimet që i ka ndërmarrë MTI-ja, deri më tani rreth kësaj çështjeje. Po ashtu, kërkoi që të kërkohet raport edhe nga Ministra e Bujqësisë për subvencionet për mbjelljen e grurit që ju ka dhënë fermerëve dhe nga MTI-ja për çështjet tregtare, me theks te veçante të grurit, se si është e rregulluar kjo çështje më ligj.

Komisioni u pajtua me propozimet e deputetit z. Shaip Muja.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Zenun Pajaziti